

Kërkesë për Shprehje të Interesit

Shteti: Kosovë

ID e projektit: P164555

Emri i kredisë së Bankës Botërore: Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore

Nr. identifikues i kontratës: XK-KCA-439250-CS-INDV

Ekspert Ligjor si anëtar i nënkomisioneve për të mbështetur Komisionin në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për zyrtarizmin e gjendjes faktike dhe mospërputhjet me Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme (Komisioni)

Historiku

Qeveria e Kosovës ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 14.60 milion dollarë amerikan për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të përmirësojë transparencën dhe cilësinë e administrimit në tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të ketë personel të përbërë nga Udhëheqësi i NjIP-it, Specialisti i Prokurimit, Specialisti i Menaxhimit Financiar, Specialist i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Specialisti Ligjor dhe personel tjetër teknik, si ekspertë të GIS/Kadastrit, etj. NjIP do të jetë përgjegjëse për implementimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve. Ajo do të mbikëqyrë të gjitha aspektet e projektit, duke përfshirë prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe masat mbrojtëse të projektit.

Në kuadër të REGIP-it, një nga aktivitetet kryesore është projekti i Rindërtimit Kadastral (RK). RK është planifikuar të zbatohet deri në 120 zona kadastrale me prioritet.

RIK do të zbatohet nga operatorët ekonomikë të kontraktuar që do të rindërtojnë informacionin kadastral në zonat e përcaktuara kadastrale. Aktivitetet e kryera nga operatorët ekonomikë do të monitorohen nga kontraktori i kontrollit të cilësisë.

Bazuar në nenin 42 të Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, AKK do të themelojë nënkomisioneve për përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi i rindërtimit dhe për të ofruar mbështetje për Komisionin gjatë këtij procesi.

NjIP aktualisht është duke kërkuar një Ekspert Ligjor në fushën ligjore të së drejtës pronësore

Objektivi i përgjithshëm

Përgjegjësitë e Ekspertit Ligjor i cili do të jetë pjesë e nënkomisioneve për të mbështetur Komisionin për Rindërtimin e Informacionit Kadastral janë të përcaktuara në nenin 42 të Ligjit nr. 08/L-237 për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MESPI) Nr. 08/2024 për Komisionet dhe Nënkomisionet për Rindërtimin e Informonit Kadastral dhe Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, si dhe çdo detyrë tjetër të kërkuar nga AKK-ja apo Komisioni i RIK-ut.

Eksperti do të vendosen në objektet e AKK-së në Prishtinë, por duhet të jetë i gatshëm të udhëtojë në lokacione të ndryshme të projektit në mbarë vendin, të mbajë takime të shumta dhe të punojë nën presion. Transporti do të sigurohet nga AKK.

Kualifikimet e nevojshme për Ekspert Ligjor

- Diplomë universitare në juridik;
- Së paku tri (3) vite përvojë profesionale përkatëse në të drejtën e pasurive të paluajtshme;
- Njohuri të mira të ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës për regjistrimin e të drejtave pronësore dhe kadastrin;
- Aftësi të shkëlqyera hartuese, analitike, komunikuese, koordinuese dhe ndërpersonale.
- Kërkohej njohja e rrjedhshme e gjuhës shqipe;
- Njohja e gjuhës angleze dhe serbe është përparësi;
- Njohuri të shkëlqyera të aplikacioneve kompjuterike (Word, Excel)

Detyrat, përgjegjësitë, përvoja e kërkuar si dhe informacionet tjera në lidhje me këto pozita janë dhënë në TR.

Periudha e performancës

Eksperti Ligjor vendor i rekrutuar do të punojë me orar të plotë (8 orë), dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të jetë deri në fund të projektit REGIP (31 gusht 2025), me mundësi vazhdimi në bazë të datës së mbylljes së projektit. Vazhdimi i kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme për të cilën dakordohet gjatë vlerësimit zyrtar të planifikuar. Pagesa do të bëhet në bazë të shumës mujore të rënë dakord në kontratë. Ekspert pritet të fillojë shërbimet pas nënshkrimit të kontratës. Eksperti do të vendoset në objektet e AKK-së në Prishtinë, por duhet të jetë i gatshëm të udhëtojë në lokacione të ndryshme të projektit në mbarë vendin, të mbajë takime të shumta dhe të punojë nën presion.

Procesi i përzgjedhjes

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të

nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në thirrjen e hapur për përzgjedhje të Konsulentëve Individual.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale dhe pa diskriminim në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose ndonjë kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.

Kriteret e vlerësimit:

- Kualifikimi i përgjithshëm - 30 pikë
- Përvoja specifike në lidhje me detyrën – 70 pikë

Konsulentët individualë të interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës: 08:00 - 16:00 (nga e hëna në të premten)

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në adresën e e-mailit të dhënë më poshtë para datës **24 Tetor, 2024, 16:00 (koha e Kosovës)**. Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati nuk do të pranohen. Aplikacioni duhet të përfshijnë një letër motivuese, CV-në dhe dokumentet shoqëruese si diploma, referenca, certifikata.

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Për vëmendje të: Specialisti i Prokurimit, REGIP.

Adresa: rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, Objekti i Arkivit, kati 2,
10 000, Republika e Kosovës

Email:

Për: prokurimi.regip@rks-gov.net

Cc: Muzaffer.Qaka@rks-gov.net